



Datë: 26.09.2025
Numër Protokolli: 6525/2025

A.nr.946/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Kaltrina Avdullahi-Prenaj, si procesmbajtëse, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.946/2025, të datës 23.05.2025, të parashtruar nga ankuesja N.A, kundër organit të punësimit: Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 si dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 26.09.2025, mori këtë:

V E N D I M

- I. **Refuzohet si e pabazuar** ankesa me numër A.nr.946/2025, e datës 23.05.2025, e parashtruar nga ankuesja, N.A.
- II. **Mbetet në fuqi** Akti përfundimtar me nr.prot:926 i datës 15.05.2025, i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, të Ministrisë së Punëve të Brendshme, lidhur shpalljen e kandidatit fitues për procedurën e pranimit me numër të referencës RN00016703, Grupi i Administrimit të Përgjithshëm, pozita Zyrtar për Regjistrimin Civil, Drejtorati i Regjistrimit të Automjeteve Klinë, Agjencia për Regjistrim Civil, si dhe Njoftimi më nr.prot:623, i datës 24.03.2025, lidhur me refuzimin e aplikacionit të ankueses.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbim civil, N.A, (në tekstin e mëtejme referuar: *Ankuesja*), më datë 23.05.2025, përmes postës elektronike (ankesa.kpmshck@rks-gov.net), ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit të datës 26.03.2025, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, lidhur me refuzimin e aplikacionit në procedurën e rekrutimit me numër reference RN00016703, për pozitën *Zyrtar për Regjistrimin Civil* Drejtorati i Regjistrimit të Automjeteve, Klinë, Agjencia për Regjistrim Civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 04.06.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa, kjo e fundit, më datë 16.06.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 3408/2025, të datës 23.05.2025, të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin e datës 26.03.2025, për refuzimin e aplikacionit; Kopjen e letërnjoftimit; Formularin e parashtrimit të ankesës së datës 23.05.2025; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 04.06.2025; Përgjigjen në ankesë të datës 16.06.2025 së bashku me dokumentet e dorëzuara nga organi i punësimit; Konkursin me numër reference RN00016703; Listën e aplikantëve (të refuzuar dhe aprovuar); Vendimin me numër protokolli 553/2025 të datës 04.04.2025; Vendimin me numër 936 të datës 01.04.2025; Planin vjetor të personelit të datës 17.01.2024; Aplikacionin me datë aplikimi 08.03.2025 të kandidatës N.A së bashku me dokumentet e bashkangjitura; Aplikacionin me datë aplikimi 09.03.2025 të kandidatës E.N së bashku me dokumentet e bashkangjitura; Njoftimin për rezultatin përfundimtar me numër protokolli 926 të datës 15.05.2025; Vendimin e Kryetarit të Këshillit për vazhdimin e afatit të lëndës.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa është e pabazuar, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Ministria e Punëve të Brendshme, më datë 14.02.2025, ka shpallë konkursin publik për pranim me numër reference RN00016703, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm, gjegjësisht për pozitën *Zyrtar për Regjistrim Civil*, Drejtorati i Regjistrimit të Automjeteve, Klinë, Agjencia për Regjistrim Civil, më klasë të pozitës Profesional 2, një (1) vende pune, i hapur për aplikim nga data 15.02.2025 deri më datë 16.03.2025.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsejtë 26 kandidatë, ndër ta edhe ankuesi, ndërsa, vetëm 11 kandidatë janë përfshirë në listën e kandidatëve që kanë plotësuar kriteret e konkursit, gjegjësisht, sipas Njoftimit të datës 26.03.2025, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ankueses i është refuzuar aplikacioni më arsyetimin së e njejta nuk ka plotësuar kriteret e konkursit, pasi që, më rastin e aplikimit për pozitën përkatëse nuk ka bashkangjitur dëshmi të mjaftueshme të përvojës së punës.

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme, më datë 15.05.2025, ka publikuar Njoftimin me numër protokolli Nr.926 për rezultatet përfundimtare, nga i cili njoftim rezulton se si kandidatë e suksesshëm për procedurën përkatëse të rekrutimit është shpallur E.N me 88.6 pikë.

Pas publikimit të Njoftimit të datës 15.05.2025, për kandidatin fitues, ankuesja brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke kundërshtuar ligjshmërinë e Njoftimit të datës 26.03.2025, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme për refuzimin e aplikacionit, mbi pretendimin ankimor se me rastin e aplikimit ka dorëzuar të gjitha dokumentet e kërkuara sipas konkursit, e të cilat e dëshmojnë përvojën e mjaftueshme për konkursin përkatës. Kërkon nga Këshilli që të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të anuloj konkursin me numër reference RN00016703 në tërësi.

Kolegji i Këshilli mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku *përcaktohet se: “Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes”*, ka analizuar në kuptim të ligjshmërisë veprimet administrative të ndërmarra në procedurën e rekrutimit RN00016703. Andaj, në kontest të këtij

përcaktimi, Kolegji fillimisht sipas shqyrtimit të aktit të shpalljes se konkursit ka gjetur se si kërkesa të përgjithshme formale në procedurën përkatëse të rekrutimit janë vendosur: **Arsimimi i kërkuar: Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor):** Arsim i lartë i paspecifikuar; Përvoja e punës e kërkuar: Së paku 1 (një) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.

Ndërsa, në kuptim të bazushmerisë së pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit i`u referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, me theks të veçantë:

-Nenit 9: 1. Kriteret e përgjithshme që një person duhet t`i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t`u pranuar si zyrtar publik në cilëndo kategori apo nivel, janë: 1.1. të jetë shtetasi Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi; 1.3. të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik; 1.7. të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe 1.8. të kaloj me sukses procedurat e pranimi të përcaktuara në këtë ligj. 2.Përgjashtimisht, për pozita specifike të zyrtares/it publik, mund të kërkojnë kriteret specifike shtesë. Procedura dhe kriteret për plotësimin e përshtatshmërisë dhe/apo të kriterëve specifike shtesë, do të përcaktohet me akt nënligjor të miratuar nga Qeveria, me propozim të ministrisë përgjegjëse për administratë publike.

-Nenit 39: 1.Pranimi në shërbimin civil bëhet në të gjitha kategoritë e shërbimit civil, nëpërmjet një procedure rekrutuese të hapur dhe publike, përveç kur parashikohet ndryshe me këtë ligj. 2. Rekrutimi për kategorinë profesionale organizohet për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe pozitë apo grup pozitash të administrimit të veçantë, sipas nevojës së institucionit dhe sipas planifikimit të NjMBNj-së”, 2. Rekrutimi për kategorinë profesionale organizohet për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe pozitë apo grup pozitash të administrimit të veçantë, sipas nevojës së institucionit dhe sipas planifikimit të NjMBNj-së. 3. Rekrutimi për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe të veçantë organizohet nga njësia përgjegjëse. 4. Përgjashtimisht përcaktimeve të këtij ligji, për institucionet që kanë nëpunës/e civil me status të veçantë, procedurat e rekrutimit i zhvillon NjMBNj e atij institucioni. 5. Shpallja e procedurës së rekrutimit për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe të veçantë, bëhet nga njësia përgjegjëse në SIMBNj-së, si dhe me mjete të tjera të përshtatshme të informimit. 6. Pranimi i aplikacioneve bëhet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e shpalljes së procedurës së rekrutimit. 7. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; dhe 7.2. vlerësimi profesional që përfshin vlerësimin e njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. 8. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional i kandidatëve bëhet nga komisioni i pranimi i krijuar për secilin grup të administrimit të përgjithshëm apo administrimit të veçantë, për të cilin zhvillohet rekrutimi....”

Po ashtu, Kolegji i Këshillit për vendosje të drejtë dhe meritore mori parasysh edhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, me konkret:

- Nenin 7: Verifikimi paraprak 1. Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidatët për pranim në shërbimin civil plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit. 2. Verifikimi paraprak kryhet nga NjMBNj, më së largu pesëmbëdhjetë (15) ditë pas kalimit të afatit për pranimin e aplikacioneve, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit. 3. NjMBNj publikon në SIMBNj dhe uebfaqen e institucionit listën e kandidatëve të cilët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato specifike. 4. NjMBNj njofton kandidatët që nuk plotësojnë kushtet për

rekrutim, duke përfshirë të gjitha kriteret dhe/ose dëshmitë e pa përmbushura jo më vonë se tre (3) ditë kalendarike nga data e publikimit të rezultateve.

Referuar kuadrit ligjor si më sipër, Kolegji i Këshillit ka konstatuar së kriteret e përgjithshme formale për pozitën e kontestuar kanë qenë në pajtim me rregulloren në fuqi për klasifikimin e vendeve të punës në shërbim civil (Rregullorja nr.06/2024) dhe së Komisioni i Pranimi i themeluar sipas Vendimit Nr.553/2025, të datës 04.04.2025, të Sekretarit të Përgjithshëm të MPB-së, është në përbërjen e përcaktuar më nenin 40 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë. Ndërsa, pretendimi ankimor i ankuesit lidhur refuzimin e aplikacionit nuk gjen mbështetje ligjore, për arsye nga analizimi i dosjes së ankueses të dorëzuar nga organi i punësimit rrjedhë së e njëjta ka poseduar dëshmi për përfundimin e studimeve themelore më datë 15.07.2021,(diploma nr.4316/0921, e datës 13.09.2021, Bachelor i Arteve në Ekonomik, specializimi Menaxhment-Kolegji Fama), ndërsa, lidhur me përvojën e punës pas diplomimit e njëjta ka ofruar dëshmi për përvojë punë por që kjo përvojë ka të bëjë më periudhën para diplomimit. Rrjedhimisht, ankuesja posedon Vërtetimin nr.prot:42/2025, të lëshuar nga Drejtori i Shkollës Fillore e Mesme e Ulët “Avni Zhabota” në Shtupel, me të cilin vërtetohet se kandidatja ka punuar pranë kësaj shkolle nga data 01.11.2002 deri më 31.08.2009, nga data 01.06.2011 deri 31.11.2011 dhe 14.04.2015 deri më 01.06.2016. (nuk është specifikuar pozita dhe angazhimi që ka pasur në këtë shkollë), e sipas aplikacionit ky angazhim ka qenë si arsimtare. Posedon Referencën e lëshuar nga Kompania e Sigurimeve Sigal në Klinë (pa numër protokolli dhe pa datë), me të cilën vërtetohet se ankuesja ka punuar për periudhën kohore 2015-2020 part-time, pranë Degës së Kompanisë në Klinë, si dhe Marrëveshjen për shërbime të veçanta Nr.prot.1245, të datës 13.07.2016, me të cilën vërtetohet se ka qenë e angazhuar si Zyrtar Regjistruar për Hartimin dhe Përditësimin e Regjistrimit të Diasporës dhe Mërgatës-Klinë, nga data 09.07.2016 deri më 08.09.2016(marrëveshje kjo që përbëhet vetëm nga fleta e parë). Andaj, mbi bazën e këtyre dëshmime rrjedhë së përvoja e punës e deklaruar nga ankuesja ka të bëjë më periudhën para diplomimit, kështu që, më të drejtë Njësia e Burimeve Njerëzore të MPB- ka refuzuar aplikacionin e ankueses duke vepruar në pajtim më nenin 39 paragrafi 7 pika 7.1 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se: *7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit...*

Po ashtu, Kolegji në vështrim të parimit të meritokracisë, si një nga parimet bazë për pranim në shërbim civil ka analizuar dosjen e aplikimit të kandidatës fituese (dokumentacionin e dorëzuar së bashku me përgjigjen në ankesë), duke konstatuar se Kandidatja E.N posedon diplomën Nr.2250, të datës 12.03.2012, të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, me të cilën vërtetohet se ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin Ekonomik, më datë 16.11.2011, në Departamentin Banka, Financa dhe Kontabilitet, duke marrë titullin Bachelor për Banka, Financa dhe Kontabilitet. Ndërsa, përkitazi me përvojën e punës pas diplomimit kandidatja ka bashkangjitur Vërtetimin e marrëdhënies së punës me Nr.prot: 263/17, të datës 26.02.2018, të lëshuar nga Departamenti i Burimeve Njerëzore në Elkos Grup sh.p.k, me të cilën dëshmohet se e njëjta ka qenë e punësuar në pozitën e punës Arkatare/Sektoriste nga data 16.09.2013 deri më datën 17.01.2017, mirëpo, sipas Pasqyrës së Trustit Pensional të datës 27.02.2025, pagesat e kontributeve pensional kanë të bëjnë më muajin gusht, shtator dhe dhjetor 2023 (tre muaj), janar-prill dhe qershor-dhjetor 2014 (11 muaj), janar-dhjetor 2015 (1 vit) dhe janar-mars dhe maj-dhjetor 2016 (11 muaj), Andaj, si pasojë e analizimit të dokumentacionit të aplikimit të kandidatit fitues, rrjedhë se e njëjti ka plotësuar kriteret e përgjithshme formale të përcaktuar me konkursin e kontestuar, e duke qenë se ka arritur numrin më të madh të pikëve, atëherë, më të drejtë njësia përgjegjëse, në këtë rast Divizioni i Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme, e ka shpallur si kandidate fitues për procedurën me numër reference RN00016703, duke vepruar kështu në pajtim më nenin 11 të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Bazuar në konstatimet si me lartë, dhe duke qenë se nuk janë evidentuar shkeljeje ligjore në procedurën e kontestuar, atëherë, Kolegji i Këshillit erdhi në përfundimin së procedura me numër reference RN00016703, është zhvilluar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë si dhe Rregulloren Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, kështu që, në kuptim të dispozitave të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenit 132, paragrafi 2, të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.946/2025

Kaltrina Avdullahi-Prenaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- *Ankueses, N.A;*
- *Njësisë se Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme; dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*